

C.nr.254/2012

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE (e vendosur ne objektin e Deges se kesaj Gjykate ne Vushtrri), Gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike te paditesit nga Mitrovica, te cilin e perfaqson av. nga Mitrovica, sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditures Komuna e Mitrovices, te cilen e perfaqeson Avokati Publik Komunal , per vertetim pronesie, vlere e kontestit 800,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt. 20.01.2015, bie kete:

AKT GJYKIM

I – APROVOHET, Kerkespadia e paditesit dhe **VERTETOHET** se paditesi nga Mitrovica, eshte shfrytzues i pjesees se ngastres katastrale nr.2993-5, ne siperfaqe prej **S=187m²**, me kultur are e klases se II , ne vendin e quajtur “Tavnik”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, i pjesees se ngastres katastrale nr.2998-1, ne siperfaqe prej **S=92m²**, me kultur are e klases se II , ne vendin e quajtur “Tavnik”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, i pjesees se ngastres katastrale nr. ne siperfaqe prej **S=63m²**, me kultur are e klases se II , ne vendin e quajtur “Tavnik”, me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, i pjesees se ngastres katastrale nr.2998-2, ne siperfaqe prej **S=15m²**, me kultur are e klases se II , ne vendin e quajtur “ , me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes dhe i pjesees se ngastres katastrale nr. , ne siperfaqe prej **S=6m²**, me kultur are e klases se II , ne vendin e quajtur “ , me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes ne siperfaqe te pergjithshme prej **S=363**, te gjitha keto sipas certifikates se pronesise nr. , ZK , e cila evidentohet ne emer te te paditures Kuvendi Komunal – Mitrovica.

II – OBLIGOHET e paditura qe t’ia njohe kete te drejte paditesit dhe t’i lejoje qe paditesi kete paluajtshmeri ta regjistroj ne emer te tij, ne librat e tokes te Zyra Kadastrale Komunale ne Mitrovica, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij aktgjykimi.

- Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesi ne padin e tij te parashtruar si dhe permes te autorizuarit te tij, ne seancat e mbajtura ka theksuar se prej vitit 1980 eshte duke e shfryterzuar kete paluajtshmeri dhe ne te ka ndertuar shtepine e banimit dhe qe nga momenti I vendosjes ka hyre ne shfrytzim dhe posedim te kesaj paluajtshmerije duke mosqene I penguar nga askush e edhe sot e shfrytizon pa kurrfar pengese.

Paditesi ne baze te shfrytezimit dhe mbajtjes e ka fituar te drejten e prones per kete paluajtshmeri, andaj ka interes juridik qe te vertetohet se ai eshte pronar i pjeses te ketyre ngastrave .

I autorizuari I paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen perfundimtare deklaroi se nga provat e nxjerrura ne shqyrtimin e sotem kryesor ne menyre te pakontestueshme u vertetua bazueshmeria e kerkekspadise, andaj gjykates I propozoj qe te njejten ta aprovoi sit e bazuar duke marre parasysh edhe precizimin e kerekspadise sipas ekspertizes se ekspertit gjeodet.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Perfaqesuesi i te paditures ne pergjigje te padise dhe precizimit te kerkespadise ne seancen shqyrtimit kryesore dhe ne fjalen perfundimtare deklaroi se edhe pse kam pershtypje se deklaratat e deshmitareve jane te mjegulluara gjykates I propozoj qe duke patur ne konsiderat thenjet nga seanca paraprake dhe rrezultateve te provave te bie vendim meritor te bazuar ligjerisht.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesor, zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pas administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nenit 8 te LPK-es, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi: procesverbalin mbi vendeshiqimin I kesaj gjykate C.nr.3254/12 te dt.05.11.2014, certifikaten mbi pronesine UL-ZK Mitrovica , ne emer te te paditures., lexoi ekspertizen gjeodete ne emer te ekspertit gjeodet te dt.06.11.2014, beri veshtrim ne skicen e terenit, ndegjoi deshmitaret dhe qe te dy nga Mitrovica dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin I kesaj gjykate te cekur me larte konstatohet se gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejte ne vend konstaton se paluajtshmerija kontestuese eshte e perkufizuar fizikisht me taraba prej druri . Ne kete paluajtshmeri gjinden objekte te ndertuara dhe ate shtepija (P+0),e ndertuar ne vitin 1980, (sipas ekspertit gjeodet ne vendshiqim) mbi themelet e se ciles beri rindertimin mbas luftes se fundit ne Kosove ne vitin 1999. Palujtshmerija kufizohet ne anen perendimore, lindore dhe jugore me prone komunale , ndersa ne anen veriore me rruget te karakterit dytesore . (gjithnje sipas ekspertit gjeodet).

Nga Certifikatat mbi te drejttat e prones se paluajtshme te cekur me lart, konstatohet se pjeset e parceleve katastrale nr.2993-5, 2998-1,2998-2, 2993-10 dhe 2993-3, evidentohen ne emer te te paditures.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet te cekur me lart, konstatohet se pas matjeve te kryera ne pjesen e parceles kontestuese nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit, me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice, ka vertetuar se pjeset e paluajtshmerise kontestuese bjen – gjegjesisht e perbene pjeset e parceleve te cekur me larte me masa dhe kufij te shenuara si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe skicen e terenit, e cila eshte pjese perberse e kesaj ekspertize dhe te aprovuar si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Deshmitari deklaroj se ai personalisht e din se paditesi Halil Tahiri jeton me familjen e tije qe 30 vite ne ate vend, e di se e ka ble nga nje person me mbiemri Shipoli apo ka qene nga Shipoli nuk jam I sigurt, ne siperfaqe rreth 3 ari. Nuk e di se kete shitblerje e kane bere me marreveshje gojore apo ne baze te ndonji marreveshje me shkirm. E di se para 30 viteve kur jane vendosur ne ate vend ka ekzistuar nje shtepi e vogel. Nuk me kujtohet saktesisht a ka qene paluajtshmeria e rrethuar por e di se aty kane jetuar prej asaj kohe. Per sa e di une paditesi prej asaj kohe kur u vendos ne ate vend jeton ne te njejten shtepi pervec disa merimetimeve, te vendosura disa dyer prej metali dhe disa merimetimeve tjera te vogla ne shtepi. Per sa e di une paditesi prej para 30 viteve kur eshte vendose ne ate vend nuk ka pase kurrfar pengese as kurrfar problemesh me askend lidhur me shfrytezimin e asaj paluajtshmerie. Keto rrethana I kam ne dijeni se une jetoj ne fqinjesi me paditesin dhe kah shtepia e tije une kaloj gjithnje sepse aty e kam rrugen per te shkuar per nevojat e mija dhe familjare.

Deshmitari deklaroj se ai personalisht e din se paditesi me familjen e tije eshte vendosur ne kete shtepi ne vitin 1978, nuk e di se prej kujt e kane bler por e di se aty ka siperfaqe me shume se 3 ari . Ne ate kohe familja e paditesit eshte vendos qysh e ceka me larte ne vitin 1978 ne nje shtepi te vogel ne form te shupave . Nuk me kujtohet a ka qene ne ate kohe e rrethuar me dicka ajo paluajtshmeri. Ne vitin 1983 pas ardhjes se fqinjit te tyre [Muensur Voca edhe keta kane filluar te merimetojne dhe te rindertojne shtepint e tyre te cilat kane qene te vjetruara, dhe te njejten kohe edhe rrethimin me taraba prej druri dhe dyer nga druri. Per sa e di une paditesi prej vitit 1978 kur eshte vendos me familjen e tije ne ate shtepi e gjere me sot nuk ka pas kurrfar pengesash e as problemesh nga askush ne shfrytezimin dhe posedimin e kesaj paluajtshmerie. Keto rrethana me jane te njohura nga se une jetoj ne fqinjesi me paditesin, dhe ate ne afersi prej 20 metrash. Me pyetjet e parfaqesuesit e te paditures drejtuar deshmitarit se sa vjecar eshte tani paditesi I njejti pergjigjet se nuk jam I sigurt se sa vjet sakt I ka por e di se I njejti I ka me shume se 40 vjec. Ne pyetjen e rradhes te parashtruar nga perfaqesuesi I te paditures drejtuar deshmitarit se ne vitin 1978 paditesi a ka hy ne banim si person I vetem apo me familje? I njejti pergjigjet: ne vitin 1978 paditesi ka hy ne ate shtepi me babain e tije dhe vellezerit e tije. Ne pyetjen tjeter se a ka qene paditesi ne ate kohe I punesuar ? deshmitari pergjigjet: ne ate kohe paditesi nuk ka qene I punesuar nga se ka qene I ri. Ne pyetjen e rradhe se personi Mensur Voca a ka ndertuar shtepine ne truall e vete te trashiguar, te blere nga dikush apo te dhene nga organi kompetent ? Deshmitari pergjigjet: Nuk jam ne dijeni se ne cfar menyre ka ardhur Mensur Voca ne ate vend por e di se ka ndertuar shtepine. Ne pyetje se sa eshte larg shtepia e nga shtepia e tani paditesit, deshmitari pergjigjet: perafersisht 40 metra.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me lart, gjykata erdhi ne perfudim dhe konstatoi se paditsi ka hy ne disponim dhe shrytezim te lire te kesaj patundshmerije tani lendore qe nga viti 1980, I cili se bashku me anetaret e familjes se tij, e ka shfrytezuar kete paluajtshmeri pa pengesa qe nga momenti I marrjes ne shrytzim e gjere me tani.

Ne baze te nenit 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat e tjera sendore, eshte percaktuar se: Personi i cili me mirebesim e ka 20 (njezet) vjet ne posedim te panderprere nje paluajtshmeri ose nje pjese te saj e fiton pronesin ne te.

Ne rastin konkret nga momenti i marrjes ne shfrytzim, paditesi e ka pasur ne shfrytezim dhe disponim te lire kete paluajtshmeri dhe ate: me mirebesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ne anen e paditesit ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e drejtes se prones perkatsisht te drejtes se shfrytzimit ne baze te mbajtjes e keto jane: mbajtja me mirebesim, koha e nevojshme si dhe shfrytezimi i papengueshem i kesaj paluajtshmerive.

Mbajtja me mirebesim ekziston nga se paditesi kete paluajtshmeri e ka shfrytzuar pa pengesa nga askush.

Koha e nevojshme mbi 20 (njezet) vite, ekziston sepse paditesi kete patundeshmeri e ka shfrytzuar qyshe nnga vitin 1980.

Gjithashtu nga 1980, paditesi ka hyre ne posedim dhe shfrytezim te lire dhe te papengueshem te kesaj paluajtshmerie te tij, gjere me tani. Prandaj, gjykata konkludon, se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit , konform nenit 40 te Ligjit per Pronesin dhe te Drejtat te Tjera Sendore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore, bazohet ne baze te nenit 450 dhe 459 te LPK-es.

Nga arsyet e cekura me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.254/2012, dt.20.01.2015.

Gj y q t a r i,
Skender Shala

KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.

Saktesine e pershkrimit e verteton: